



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:138145

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05513352

**NË EMËR TË POPULLIT**

**P.nr../..**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit Sh.. O.. për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshme PP/II-nr.1006/22 të datës 06.06.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestarë të hapur për publikun me datë 19.03.2024, në prezencë të Prokurores së Shtetit Ardiana Vesili, të pandehurit Sh.. O.., me datë 22.03.2024 mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me datë 27.03.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:**

**Sh.. (E..) O..**, i lindur më datë ..... në S..., në shtetin e Sh., nga i ati Enver, e ëma F., mbiemri i vajzërisë Sh., me vendbanim në rr. A.. D., Rajoni I në fshatin V., K.. P., ka te kryer ... klasë fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, posedon numër të telefonit ....., i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal .... të lëshuar nga MBP Shqipëri, i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i Republikës së Shqipërisë.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se,**

Me datë 06.08.2022, rreth orës 19:50, në rr."S.. K.." pikërisht në parkun e qytetit "I.. R.", në P., pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge në atë mënyrë që, Policia e Kosovës, gjatë patrullimit rutinë në terren hasin të pandehurin Sh., ku gjatë kontrollit i gjejnë substancë narkotike në gjepin e majtë të pantallonave e cila pas verifikimit me pajisjen NarTest NTX 2000, ka rezultuar se e njëjta është substancë narkotike e llojit Marihuanë në sasi prej 1.2 gram, të cilën i pandehuri e kishte për konsum personal ku më pas substanca narkotike sekuestrohet nga ana e policisë,

- me çka ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 7, 17, 38, 39,42, 43, 44, 69, 70, 71, 72, 269 par 1 të KPRK-së dhe nenit 6, 7, 364 dhe 365 të KPPRK- së, të pandehurit Sh.. O.. i shqipton:

**DËNIM ME BURG** në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë ) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit komfor nenit 44 të KPRK-së, i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumën prej 200,00 (dyqind) euro dhe **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 200,00 € (dyqind euro).

Konform nenit 76 të KPRK-së të pandehurit i shqiptohet **DËNIM UNIK ME GJOBË** në shumë prej **400,00 € (treqind euro)**, të cilin dënim i pandehuri do ta paguaj brenda 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti shndërrohet në dënim me burg, ku një ditë burg do ti llogaritet 20 euro.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumë prej 40,00 € në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Te akuzuarit i konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuan ne peshë prej 1.2 gram.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme me datën 04.07.2022 ka ngritur aktakuzën PP.nr.1260/22 ndaj të pandehurve F.. R.. dhe Sh.. O.. secili veç e veç për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së.

Ne seance e shqyrtimit fillestare të datës 19.03.2024 gjykata ka marr aktvendim me të cilin e ka veçuar procedurën ndaj te pandehurit F.. R.., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme PP/II-nr.1260/22 të datës 04.07.2022, për shkak të veprave penale posedim i pa autorizuar i substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së. nga procedura penale ndaj të pandehurës Sh.. O.. i akuzuar për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së, Procedura e veçuar ndaj te pandehurit F.. R.., i akuzuar për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së, do të procedohet sipas numrit P.nr.232/24.

Ndërsa shqyrtimi fillestar ka vazhduar në raport me te pandehurin Sh.. O.. i akuzuar për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së, e pasi qe gjykata është siguruar qe Prokurori i Shtetit i ka përmbushur detyrimet qe kane te bëjnë me zbulimin e provave ne pajtim ne neni 244 i KPPRK-se.

Me pas gjykata e ka njoftuar te pandehurin Sh.. O.. për pasojat dhe benefitet e pranimit te fajësisë, dhe paraprakisht i ka dhënë mundësin te pandehurit të deklarohet lidhur me pranimin e fajësisë.

I pandehuri Sh.. O.. në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar: se e pranoj fajësinë për veprat penale sipas aktakuzës, kamë qenë përdorues, jam penduar dhe shton se është e vërtetë që e kam kryer këtë vepër dhe premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet të këtilla.

Ne vlerësimin e pranimit te fajësisë nga ana e te pandehurit Sh.. O.. gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit te Shtetit Ardiana Veseli e cila ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, i njëjti pranim është bere ne mënyrë vullnetare nga i pandehuri dhe po ashtu gjen mbështetje ne shkresat e lëndës.

Gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se ne seancën e shqyrtimit fillestar nuk kanë ekzistuar rrethana për hedhjen e aktakuzës, janë vërtetuar faktet nga neni 248 par. 1 pika 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 te KPPRK-se, aktakuza mbështet ne këto prova siç janë, Raporti informues i policit hetues V.. G.. #9764 e dt. 08.06.2022, Raporti i policit R.. P.. #7062 e dt.08.06.2022, Raporti i oficerit B.. N.. #10800 e dt.08.06.2022, Deklarata e te dyshuarit F.. R.. e dhënë ne Stacionin Policor ne Pejë me dt. 08.06.2022, Deklarata e te dyshuarit F.. R.. e dhënë ne Stacionin Policor ne Pejë me dt. 08.06.2022, Vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshëm te sendeve e dt. 08.06.2022, Deklarata e te dyshuarit Sh.. O.. e dhënë ne Stacionin Policor ne Pejë me dt. 08.06.2022, Vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshëm te sendeve e dt. 08.06.2022, Raporti i analizës se narkotikeve NarTest e dt. 24.06.2022, Foto-dokumentacion i substancës narkotike, andaj ka marr aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit Sh.. O.. i cili pranim mbështet ne provat ne baze te se cilave bazohet aktakuza është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprave penale nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 par.1, 2 dhe 3 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurën, gjykata mori pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata ka gjetur shkallën e lartë të dashjes ne kryerjen e veprës penale, i njëjti me parë ka qenë i dënuar për veprën e njëjtë penale me Aktgjykimin e kësaj Gjykata P.nr.1072/19 i datës 26.08.2020 me dënim me gjobë dhe me aktgjykimin P.nr.837/22 të datës 19.10.2023 po ashtu për veprën e njëjte penale me dënim me gjobë.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vlerësuar se me dënimin e shqiptuar si ne dispozitat te këtij aktgjykimi mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK i cili konsiston në

parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së, gjykata i obligoi të akuzuarin që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe atë për paushallit gjyqësor në shumë prej 20,00 € dhe për taksen për programin për kompensimin e viktimave të krimit 20,00 €.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL  
2022:138145, 27.03.2024**

**Bashkëpunëtorja Profesionale**

Edona Berisha Kastrati

**G j y q t a r i**

Musë Povataj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.